



UNIVERSITETI I SHKODRËS

“Luigj Gurakuqi”

SENATI

Nr. 155 prot.

Shkodër, më 18. 01. 2017

RELACION

Mbledhja e Senatit Akademik e datës 18.1.2017.

Senati Akademik (SA) i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në mbledhjen e tij të datës 18.1.2017, trajtoi këto çështje:

1. Shqyrtimin e kriterëve të pranimit të studentëve të vitit të parë në programet studimore që ofron USH për ciklin e parë Bachelor për vitin akademik 2017-2018, sipas propozimeve të derguara nga dekanatet e fakulteteve të USH, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25; në Statutin e USH neni 12 pika 5/ m.
2. Shqyrtimin e propozimit të Rektoratit për miratimin e:
 - a. të strukturës organizative dhe analitike të USH për 3-mujorin e parë të vitit 2017;
 - b. të disa elementëve të paketës fiskale për vitin 2017 për USH;
 - c. detajimit të grantit të pakushtezuar të USH “Luigj Gurakuqi” për 3-mujorin e parë të vitin 2017 se bashku me regjistrin e parashikimit të prokurorit publik për USH;në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38.1/ç, h, neni 49/c, ç dhe neni 109; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); të Ligjit nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017; udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, dt. 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar); në Statutin e USH neni 12 pika 5/ c, dhe 5/d
3. Miratimin e ndryshimit të Rregullores së brendëshme egzistuese të studimeve në programin e ciklit të tretë “Doktoraturë” të ofruar nga USH, kreu “Diplomimi” neni 43 “Marrja e diplomës” pika 2, në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH” neni 33 pika 3, nenit 38 pika 1/d, neni 71, neni 91 pika 1 dhe 3; dhe në mbështetje të Statutit të USH neni 12 pika 5/r, dhe nenit 13 pika 4

Fillimisht SA diskutoi kriteret e pranimit të kandidatëve konkurrues si student në programet studimore që ofron USH për ciklin e parë Bachelor për vitin akademik 2017-2018, të

propozimeve të derguara nga dekanatet e fakulteteve të USH. Këto kritere përcaktohen nga disa element: koeficientët e shkollave të mesme, nota mesatare për të gjitha lëndët e shkollës së mesme, e llogaritur sipas VKM nr.407 dt 01.06.2016, dhe nota në grup lëndët e përcaktuara nga dekanatet sipas programeve përkatëse të studimit të këtij cikli. Duke parë përvojën e vitit të kaluar u vlersuan si kritere grup lëndët dhe jo lëndët e veçanta. Për nxënësit konkurrues që nuk kanë zhvilluar lëndë specifike që janë përfshirë në këto kritere, nuk vlersohen me zero në llogaritjen e pikëve por merret nota e lëndëve të fushës përkatëse. Të gjitha këto kritere pranimi të kandidatëve konkurrues që aplikojnë për të ndjekur programet e studimit Bachelor të ofruara nga USH u miratuan unanimisht nga anëtarët e SA pjesmarrës në këtë mbledhje (16 anëtarë). Kriteret sipas degëve i janë bashkangjitur Vendimit të Senatit Akademik të USH nr. 148 datë 18.01.2017.

Përsa i përket pikës së dytë të çështjeve të trajtuara në këtë mbledhje, fillimisht u diskutua rreth strukturës organizative dhe analitike të USH. U ra dakort unanimisht nga SA që për tremujorin e parë të vitit 2017 të miratohet struktura organizative dhe analitike e USH njësoj si në vitin 2016 duke bërë vetëm ndryshime të emërimeve të reja të dala nga zgjedhjet në USH në vitin 2016. U la detyrë nga SA që të bëhet studim i detajuar nga strukturat përkatëse të USH për strukturën organizative dhe analitike të USH që do të jetë pas tremujorit të parë të vitit 2017 dhe të paraqitet për diskutim në mbledhjen e radhës së SA.

Gjithashtu SA shqyrtoi disa element të paketës fiskale për vitin 2017, ku propozohet masa e vlerës së tarifave për shërbimet që ky institucion ofron në rastet ku ligji e lejon. Këto përbëjnë të ardhura të pritshme të caktuara nga vetë USH për t'u siguruar nga: Shërbime për të tretët; Laboratori; Qiratë. Për masën e vlerave të tarifave të shërbimeve për të tretët të ofruara nga USH (të gjitha llojet e vertetimeve, dokumenti i diplomës dhe suplementi i saj, tarifë transferimesh të studimeve) u ra dakort nga SA që të miratoheshin të njëjta me ato të vitit 2016. Ndërsa masa e vlerave të propozuara për tarifat e shërbimeve të laboratorit të USH për analizat mikrobiologjike që ai ofron bazohej në eksperiencën e viteve të mëparshme dhe në testimin e tregut. Për këto vlera u ra dakort unanimisht nga SA që të miratoheshin për vitin 2017 të njëjta me ato të vitit 2016. Propozimet për dhënie të ambjenteve të USH me qira bazoheshin në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë (me ndryshime); në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore". SA ra dakort unanimisht që të miratoheshin propozimet e reja për masat e tarifave të marrjes me qera të ambjenteve të USH mbi baza orare të përdorimit të tyre.

SA shqyrtoi edhe propozimin nga Rektorati për detajimin e grantit të pakushtëzuar për 3-mujorin e parë të viti 2017 për USH. Në këtë detajim mbahej parasysh struktura organike e vitit 2016 e mbajtur e pandryshuar në tremujorin e parë të 2017. Gjithashtu në detajimin e grantit të vitit 2017 merreshin në konsideratë disa shpenzime operative të cilat duhej të prokuroheshin në mënyrë emergjente, si: shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike, kancelaria, ndërsa planifikimi për shpenzimet ujë dhe drita bëhej për të mbuluar vetëm 3 muajt e parë të vitit 2017. Prandaj Rregjistri i parashikimit të prokurorimeve publike bëhej vetëm për një pjesë të vlerës së grantit të pakushtëzuar të vitin 2017. Diferenca tjetër e grantit mbetej për t'u detajuar. Për të gjitha këto, SA ra dakort unanimisht.


Relacionit i bashkangjitet vendimi i SA së USH nr.150, datë 18.01.2017 së bashku me pasqyrat përkatëse për strukturën organizative dhe analitike të USH për 3-mujorin e parë 2017, për disa element të paketës fiskale të vitit 2017, për detajimin e grantit të pakushtëzuar për tremujorin e parë të vitin 2017 për USH dhe regjistrin e parashikimit të prokurorimeve publike (me kufizimet përkatëse për detajime të mëtejshme pas tremujorit të parë të viti 2017), të cilat i përcillen për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit të USH.

Me kërkesë nga Instituti i Albanologjisë pranë USH, u shqyrtua nevoja e një ndryshimi në Rregulloren egzistuese të studimeve në programin e ciklit të tretë "Doktoraturë" të ofruar nga USH. Konkretisht, në kreun "Diplomimi" neni 43 "Marrja e diplomës" u ra dakort unanimisht që pika 2 e këtij neni: "Diploma nënshkruhet nga Kordinatori i Doktoraturës dhe Rektori.....", të ndryshohet duke e saktësuar që "Diploma nënshkruhet nga Dekani përkatës i Doktoraturës dhe Rektori.....". Kjo u bë që Rregullorja e shkollës së Doktoraturës të jetë në të njëjten linjë me elementët e kësaj diploma të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse e arsimit dhe të regjistruara në regjistrin shtetëror të diplomave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit në vendin tonë. Relacionit i bashkangjitet vendimi i SA për këtë.

Relacioni mbi mbledhjen e Senatit Akademik të USH-së të datës 18.1.2017 do të pasqyrohet në website të USH-së.

Sekretari i Senatit

Prof. as., dr. Mirjam Dibra



Kryetari i Senatit

Prof. dr. Adem Bekteshi

